nuk janë ose kanë qenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në nenin 42 të Aktit Normativ nr.9/20197.

• Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

• Operatori ekonomik _____ nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

• Operatori ekonomik _____ ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Në çdo rast, autoriteti përgjegjës ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Nënshkrimi i ofertuesit _____

Vula _____

7 Autorizoj Autoritetin përgjegjës të bëjë verifikimet përkatëse të gjendjes gjyqësore të personave të deklaruar në këtë Deklaratë

Shtojca 11

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

DEKLARATË MBI GARANTIMIN E ZBATUESHMËRISË SË DISPOZITAVE LIGJORE NË
MARRËDHËNIET E PUNËS

Deklaratë e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Përgjegjës _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____ me cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

- Operatori ekonomik _____ garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____ lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____ nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 12

[Shtojcë për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik]
FORMULAR VLERËSIMI

(Ky formular do të shoqërohet me Akt kolaudimin dhe situacionet)

Autoriteti Përgjegjës /Investitori	
Adresa/Tel.	
Emri i Titullarit/Administratorit	
VËRTETOJ SE:	
Autoriteti Përgjegjës /Investitori ka nënshkruar kontratën me	
Emri i operatorit NIPT/ Bashkimit të operatorëve NIPTET/ Nënkontraktoret NIPTET	
Adresa/t	
Objekti i kontratës:	
Data e fillimit të kontratës	Data e mbarimit të kontratës
Vlera sipas kontratës	Vlera e realizuar
% e bashkimit të O.E. dhe përshkrimi i punëve të kryera nga secili anëtar Nënkontraktoret.	
Vlerësimi	(shprehur me fjalë)
	E përmbushur E papërmbushur
Firma	
Vula e Autoritetit Përgjegjës	

Shtojca 13

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]
 MBI DISPONIMIN E MAKINERIVE

Operatori ekonomik:_____

Deklaroj se zotëroj mjetet pajisjet teknike dhe asete të tjera fizike për të realizuar kontratën me objekt:_____

Në pronësi				
Lloji i Mjetit	Targa	Nr. Lejes qarkullimit	Nr. Shasisë	Të tjera
1				
2				
3				
4				
5				

Dhe

Me qera	
---------	--

Lloji i Mjetit	Targa e mjetit	Nr. Lejes së qarkullimit të mjetit	Nr. Shasisë së mjetit	Nr. Kont së qerasë (noterisë)	Afati i kontratës së qerasë (Data e fillimit dhe mbarimit)
1					
2					
3					
4					
5					
6					

- shto/fshi rreshta të tjerë nëse nevojitet.

Ne autorizojmë autoritetin përgjegjës të verifikojë informacionin e dhënë në këtë tabelë.

PERSONI I KONTAKTIT (për këtë ofertë)

Emri:

Adresa:

Nr. Telefonit:

Faks:

E-mail:

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 14

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

DEKLARATË MBI NDËRTIMET CIVILE DHE INDUSTRIALE⁸

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Përgjegjës _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Operatori ekonomik _____, nuk është subjekt i ndërtimeve civile (godina banimi ose ndërtesa të tjera shtetërore) dhe industriale të projektuara, ndërtuara, të mbikqyrura dhe/ose të kolaudura, të dëmtura nga ngjarja e fatkeqësisë natyrore, të përcaktuara në nenin 42/5/ë të Aktit normative nr.9/2019.

⁸ Akti normativ nr.9, date 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” neni 42, pika 5 shkronja ë).

Personi/at në cilësinë e aksionarit, oraktu, administratorit dhe ose anëtarët e një organi administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësi i tij aksionar ose ortak duhet të deklarojnë se nuk kanë pasur kompetenca vendimarrëse në një shoqëri, ku ndertimet civile civile (godina banimi ose ndërtesa të tjera shtetërore) dhe industriale të projektuara, të ndërtuara, të mbikëqyrura dhe/ose të kolaudura, nga kjo e fundit janë të dëmtuara nga ngjarja e fatkeqësisë natyrore, të përcaktuara në nenin 42/5/ë të Aktit normative nr.9/2019.

Në çdo rast, autoriteti përgjegjës ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shënim: Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit duhet të plotësojë këtë deklaratë.

Shtojca 15

[Shtojce per tu plotesuar nga Autoriteti Përgjegjës]

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 42 të Aktit Normativ.
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet përgjegjëse.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rasti se kemi grupe operatorësh ekonomikë, secili prej operatorëve duhet të dorëzojë vetdeklarimet, sipas kësaj Shtojce.

Në çdo rast, autoriteti përgjegjës ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim grup operatorësh ekonomikë, duhet te dorezohet: Marrëveshja e bashkëpunimit⁹ ndërmjet operatorëve ekonomikë.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Përshkrimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; (Kjo shtojce dorezohet ne fazen e dyte).*

b. *Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 4;*

c. *Sigurim oferte sipas Shtojcës 5;*

ç. *Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;*

d. *Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 8;*

dh. *Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës Shtojces 11;*

e. *Formular vlerësimi sipas Shtojcës 12;*

f. *Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve/makinerive sipas Shtojcës 13;*

g. *Deklaratë mbi ndërtimet civile dhe industriale sipas aktit normative sipas Shtojcës 14;*

gj. *Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri*

2. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapaciteti Ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kritereve të përgjithshme, sipas shtojcës 10.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2018, 2019, 2020, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës në procedurën e prokurimit.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilanci vjetore, për vitet financiare 2018, 2019, 2020, te konfirmuara nga autoriteti perkates, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika ”c”, të Ligjit Nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku bilanci e dy viteteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

⁹ Ligji nr. 162/2020 “Per prokurimin publik” neni 14

2.2.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë vertetim se subjekti ka paguar të gjitha detyrimet e maturuara të taksave dhe tarifave vendore, në vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitin 2021, sipas afateve të përcaktuara në ligjin 9632/2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e informacionit të paraqitur.

2.3 Kapaciteti teknik / Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës,

ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 2.3.1/a, plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

i) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me:

- Kontratën/at e Sipërmarrjes
- Formularin e vlerësimit
- Situacionin Përfundimtar të punimeve
- Fatura tatimore për situacionin përfundimtar

ii) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me:

- Kontratën/at e Sipërmarrjes
- Akti kolaudimit
- Situacionin Përfundimtar të punimeve
- Fatura tatimore për situacionin përfundimtar

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.2.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2.3.2. Në bazë të neni 39 të LPP, kur punët prokurohen me kontratë me çelësa në dorë:

- i. Kur autoriteti kontraktor nuk ka hartuar projektpreventiv, por ka vetëm një projektide, apo detyrë projektimi dhe terma reference për objektin që prokuron.
Në këtë rast, autoriteti kontraktor kërkon nga kontraktori hartimin e projektpreventivit, si dhe realizimin e punimeve të zbatimit të këtij projekti, pas miratimit paraprak të tij nga autoriteti kontraktor.

Autoriteti/enti kontraktor duhet të kërkojë nga ofertuesit disponimin e kapaciteteve teknike për realizimin e secilës fazë të sipërcituar: për hartimin e projektit, si dhe për realizimin e tij, duke lejuar edhe mundësinë që projektimi mund të nënkontraktohet, apo që ofertuesi (zbatuesi i punimeve) të paraqesë kontratë bashkëpunimi me subjekte që operojnë në fushën e projektimit dhe që plotësojnë të gjitha kriteret e hartuara nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë qëllim. Në këtë rast kontraktori ka përgjegjësinë e realizimit të punëve, sipas projektpreventivit të miratuar paraprakisht nga autoriteti kontraktor, pa kërkuar asnjë fond shtesë, përveç vlerës së kontratës së prokurimit, që në çdo rast, përfshin të gjitha detyrimet fiskale në fuqi.

Për sa më sipër ofertuesit duhet të disponojnë kapacitetet teknike për hartimin e projektit në njërën në format e përmendura nga neni 39 i LPP, i cili të disponojnë licencat

2. Projektues Arkitekt:

- a. -Projektim arkitekturor për objekte banimi-objekte industriale-objekte turistike.
- d. -Projektim peizazhi, sistemim sipërfaqe të gjelbra, lulishte e parqe.

3. Projektues Konstruktore:

- a. -Projektim objekte civile-turistike-industriale prej murature e skelet b/a deri në 5 kate.
- b-1. -Projektim objekte civile-turistike-industriale prej murature e skelet b/a deri në 5 kate.

4. Projektues Instalator:

- a. -Projektim të instalimeve hidrosanitare
- c. -Projektim të linjave të rrjeteve elektrike për objekte civile e industriale.
- f. -Projektim të sistemeve kundër zjarrit.
- i. -Projektim i ndricimit rrugor, shesheve, dekorativ, ndricimit të objekteve të mëdha sportive, porteve, aeroporteve etj.
- j. -Projektim të rrjeteve të telefonisë, citofonisë, fonisë, internetit, TV, akses kontroll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit të zjarrit etj për objektet civile e industriale.

5. Projektues Vepra Hidraulike:

- b. -Projektim furnizim me ujë – kolektore shkarkimi.
- c. -Projektim ujesjelles kanalizime urbane – rurale.

8. Projektues Gjeodet:

- a. -Rilevime inxhinierike.

10. Projektim i impianteve të prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike;

- e. -Projektim kabina elektrike të rrjetit shpërndarës – linja të tensionit të ulët – të mesëm.

2.3.2/a Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI

- N.P – 1 / A Punime gërmimi në tokë.
- NP-3 / E Rikonstruksion dhe mirembajtje godinash civile dhe industriale, veshje fasada.

- NP-12 / B Punime te inxhinierise se mjedisit

PUNIME SPECIALE NDËRTIMI

- NS-1 A Punime për prishjen e ndërtimeve.
- NS-2 / A Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirembajtja e tyre.
- NS-4 / C Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami.
- NS-14 / A Impjante të brendëshme elektrik telefoni, radiotelefoni, tv, etj.
- NS-18 / B Punime topogjeodezike

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastruktura dhe Energji, (ose Ministrise kompetente te kohes) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, e miratuar me VKM- ne, Nr.42, date 16.01.2008). Mosparaqitja ne kete forme eshte kusht skualifikues.

2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

Inxhinier Ndertimi	2 (dy)
Inxhinier ndertimi (Profili strukturist)	1 (nje)
Arkitekt	2 (dy)
Inxhinier Elektrik	1 (nje)
Inxhinier Hidroteknik	1 (nje)
Inxhinier Gjeodet	1 (nje)
Inxhinier Elektronik	1 (nje)
Inxhinier Mjedisi	1 (nje)

Secili prej pjestarëve të drejtuesve teknik të mësipërm, duhet te jetë ne Listëpagesat te pakten 3 muajt e fundit si dhe te figurojne në licensën e shoqërisë.

Per secilin prej pjesëtareve të stafit duhet të paraqitet:

- kontratë noteriale pune e vlefshme
- diploma

2.3.4 Operatori ekonomik duhet te kete staf te certifikuar si me poshte:

- 1 (një) Inxhinier qe duhet të jetë i pajisur me certifikatë/dëshmi trajnimi (specialist për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë) që tregon pjesëmarrjen e tij në kurse specifike për sigurinë, të organizuara nga subjekte të njohura publike ose private, sipas kërkesave të ligjit Nr. 10237 date 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin ne pune” dhe V.K.M. Nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”.
- 1 (nje) inxhinier i cili të disponojë certifikatë për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave.

- 1 (nje) ekspert zjarrefikes te licensuar.

Per stafin e kërkuar si më sipër, duhet të paraqitet: Certifikatat perkatese te dhëna nga një organizëm i licensuar/certifikuar certifikimi shqiptar ose i huaj, kontrata e punes, diplome, si dhe te figurojne ne listepagesat e kompanise te pakten 3 muajt e fundit.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të ketë staf mbështetës të punësuar punonjesit e mëposhtem:

a) Punonjes te diplomuar/specializur sipas legjisalcionit te aftesimit profesional:

- | | |
|---------------------------------------|-------------------|
| - Teknik ndertimi | 4(kater) |
| - Specialiste punime elektrike | 5 (pese) |
| - Specialiste punime elektronike | 5 (pese) |
| - Specialiste per punime kondicionimi | 5 (pese) |
| - Hidraulik | 5 (pese) |
| - Karpentier | 15(pesembedhjete) |
| - Murator dhe suvatues | 15(pesembedhjete) |
| - Bojaxhi | 15(pesembedhjete) |

Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme; diploma ose certifikata profesionale, si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë te pakten 3 muajt e fundit. Diplomat/certifikatat qe nuk jane leshuar sipas legjislacionit perkates do te konsiderohen jote sakta dhe behen shkak per veprime te metejshme sipas parashikimeve perkatese te ligjit te prokurimit publik.

b) Specialiste te certifikuar per përdorimin e skelave

shoqeruar me certifikaten perkatese 15 (pesembedhjete)

Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme; certifikata te leshuara nga instuticione te licensuara sipas legjisalcioniet perkates , si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për te pakten 3 muajt e fundit.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar, të vërtetuar me kontratë noteriale pune të vlefshme, Urdhër mjeku, diplomë dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë 3 muajt e fundit 1 (një) mjek të përgjithshëm. Ne rastin e J.V cdo anetar duhet te kete te punesuar nje Mjek te Pergjithshem. Kjo gjithnje referuar VKM Nr. 108, datë 09.02.2011 “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”, i ndryshuar, ku parashikohen mënyrat e sigurimit të shërbimeve mjekësore, në bazë të numrit të punonjësve që punëdhënësit kanë të punësuar në subjektet e tyre, dhe sipas sektorëve të industrisë, të përcaktuara në këtë VKM.

Nëse OE nuk kanë personat e ngarkuar përgjegjës, me aftësi dhe kualifikimet e duhura, pra nese nuk kane mjek te punesuar, mund t'i sigurojnë këto shërbime me anë të marrëdhënieve kontraktore me persona apo subjekte të specializuara për këtë qëllim.

2.3.7 Operatori Ekonomik duhet te disponoje mjetet e mëposhtme:

Nr	Lloji i makinerive	Pronësia	Njësia	Sasia
1	Kamion me kapacitet mbajtes mbi 25 ton	Ne pronesi ose me qera	cope	5
2	Kamion me kapacitet mbajtes mbi 20 ton	Ne pronesi ose me qera	cope	2
3	Kamion me kapacitet mbajtes 10-15 ton	Ne pronesi ose me qera	cope	5
4	Kamion me kapacitet mbajtes 3.5-5 ton	Ne pronesi ose me qera	cope	5
5	Kamion me kapacitet mbajtes 1-3 ton	Ne pronesi ose me qera	cope	5
7	Autobetoniere vetengarkuese mbi 3.5 m3	Ne pronesi ose me qera	cope	2
8	Autopompe Betoni	Ne pronesi ose me qera	cope	1
9	Autobot Uji	Ne pronesi ose me qera	cope	2
10	Eskavator me Goma	Ne pronesi ose me qera	cope	1
11	Fadrome me Goma	Ne pronesi ose me qera	cope	1
12	Skeleri	Ne pronesi ose me qera	m2	20,000
13	Pompe suvatimi	Ne pronesi ose me qera	cope	5
14	Autovinc	Ne pronesi ose me qera	cope	1
15	Motogjenerator	Ne pronesi ose me qera	cope	1
16	Betoniere	Ne pronesi ose me qera	cope	20
17	Vibratore	Ne pronesi ose me qera	cope	5
18	Matrapik	Ne pronesi ose me qera	cope	5
19	Depozita Uji 5000 L	Ne pronesi ose me qera	cope	2
20	Pompa Uji	Ne pronesi ose me qera	cope	5
21	Pirune ngrites per levizjen e materialeve	Ne pronesi ose me qera	cope	2
22	Ngrites peshash ne lartesi	Ne pronesi ose me qera	cope	2
23	Nivelues Lazer	Ne pronesi ose me qera	cope	1
24	Konteiner Ndertimi Stacioner	Ne pronesi ose me qera	cope	1
25	Vinc Kulle	Ne pronesi ose me qera	cope	1
26	Prerese Pllakash	Ne pronesi ose me qera	cope	2

- ☐ Kokore +Jeleke fosforoshente, minimumi 100 copë
- ☐ Rripa lidhës sigurimi për punime në lartësi minimumi 30 copë
- ☐ Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 5 copë
- ☐ Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 10 copë
- ☐ Komplet i ndimës së shpejtë minimumi 5 copë
- ☐ Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 20 copë

Per te deshmuar kete, Formulari i shtojces te DST duhet te shoqerohet me dokumentat e meposhtme:

- ☐ Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vertetojnë pronësinë e mjetit:- certifikatën e pronësisë; -leja e qarkullimit, kontrolli teknik, siguracioni, leja e transportit dhe foto.

- ☐ Ndersa per mjete te marra me qera krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qerase e cila dhe duhet te jete e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te punimeve deri ne perfundimin e plote te punimeve.
- ☐ Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë ne pronesi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit, dhe fatura tatimore perkatese, ndersa per mjete te marra me qera krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qerase e cila duhet te perfshije objektin perkates dhe duhet te jete e vlefshme per te gjithë periudhene realizimit te punimeve deri ne perfundimin e plote te punimeve.

2.3.8 Të jetë i pajisur me licence nga Qendra Kombetare e licensimit (QKL) Kodi III.2.B “Për grumbullim dhe transport i mbetjeve inerte”.

2.3.9 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Çertifikuar sipas standarteve ISO te leshuara nga organizmat e vleresimit te konformitetit te cilat janë te akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise, konkretisht:

- ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë “ lëshuar nga Institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim ose ekuivalentin e saj
- OHSAS 18001:2015 ose ekuivalente 45000 mbi “Shëndetin dhe sigurimin në punë”, ose ekuivalentin e saj
- ISO 14001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të ambientit” ose ekuivalentin e saj

2.3.10 . Cdo ofertues do te paraqese PLANIN E SIGURISE NE KANTIER per punimet ne nje objekt te ngjashem te realizuar ne format sipas VKM nr. 692 date 13.12.2001 “Per masat e vecanta te sigurimit dhe ruajtjes se shendetit ne pune, te ndryshuar me VKM nr. 742 date 06.11.2003 sipas kerkeseve, si rrethimi provizor, depozitimi i materialeve kryesore dhe mbetjeve, ambientet e kantierit, rruge kalimet, tabelat e sig. teknik etj.

2.3.11 Operatori ekonomik per materialet si me poshte:

- Bojrat
- Pllakat
- Materialet e termoizolimit dhe suvase (Polisterol, Rrjete, Grafiato, Llaç, Fino):
- Materialet hidroizoluese (Katrama, Hidroizolues bikomponent)

Per keto materiale operatori ekonomik duhet te paraqese kontrate furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar, katalogjet e ketyre materialeve me specifikimet perkatese te cilat duhet te korrespondojne me specifikimet e kerkuara . Dokumetacioni te permbaje identifikimim e qarte te aktivitetit te prodhuesit. Ne rastin e kontrates me distributorin te paraqitet marredhenia e distributorit me prodhuesin

2.3.12 Operatori Ekonomik duhet te paraqese nje kontrate te lidhur me nje laborator i cili te jete i akredituar nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit per kryerjen e analizave per llacet, betonet etj.

2.3.13 Operatori Ekonomik duhet te paraqese kontrate furnizimi per materialet inerte. Kontrata te shoqerohet me leje mjedisore.

2.3.14 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej 150 (*njeqind e pesedhjetë*) punonjes, me kohe te plote, për periudhën per 3 muajt e fundit e vertetuar kjo me:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën per 3 muajt e fundit.
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën per 3 muajt e fundit.

Sqarim për operatorët ekonomikë: Në bazë të ligjit Nr.87/2019 “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit” si dhe Njoftimit të përbashkët të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Nr.25366 Prot, datë 30.12.2020 dhe Agjencisë së Prokurimit Publik Nr.8480 Prot, datë 30.12.2020, Autoriteti Kontraktor Bashkia Mirdite informon se për nënshkrimin e një kontrate në përfundim të procedurës, operatori ekonomik duhet të ketë:

- *Kopje të Çertifikatës elektronike për Fiskalizimin, për Tatimpaguesit që përdorin Platformen Qendrore të Faturave.*
- *Kopje të Çertifikatës elektronike për Fiskalizimin dhe Kopje të vlefshme të Kontratës së lidhur me Shoqërinë e Çertifikuar për zgjidhjen softwerve-ike në përdorim, për tatimpaguesit që lëshojnë faturat nëpërmjet zgjidhjes software-ike.*
- *Vetedeclarim i postes zyrtare elektronike te subjektit.*

Autoriteti përgjegjës mund të përcaktojë kritere kualifikimi sipas natyrës dhe objektit të prokurimit duke pasur respektuar kuadrin regullator të rindërtimit dhe LPP.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 16

(Shtojcë për t’u plotësuar nga autoriteti përgjegjës)
PROJEKTI I ZBATIMIT DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE

Përshkrimi i të dhënave teknike të punëve objekt prokurimi të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë te ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Skicimet, Planimetritë e Objektit etj:

Specifikimet Teknike të Materialeve: Bashkengjitur me DST

Grafiku i Punimeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to: Eshte per fazen 2

Shtojca 17

(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti përgjegjës)
PREVENTIVAT E PUNIMEVE

Eshte per fazen 2

Shtojca 18

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Përgjegjës]

GRAFIKU I ZBATIMIT TË PUNIMEVE

Kohezgjatja e kontrates ne total eshte 10 muaj.

Eshte per fazen 2

Shtojca 19

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Përgjegjës]

NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR¹⁰

[Vendi dhe data]

10 Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore

[Emri dhe adresa e autoritetit përgjegjës]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Aktin Normativ nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” .

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u skualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Përgjegjës ka shkelur Aktin Normativ gjatë procedurës së prokurimit publik për rindërtimin, atëherë kenë të drejtë të ankoheni siç parashikohet në nenin 42 të Aktit Normativ nr.9/2019.

Me respekt
< Emri >

Shtojca 20

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Përgjegjës]

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data_____]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

* * *

Lista e operatorëve ekonomikë të kualifikuar në përfundim të fazës së parë të procedurës së sipërcituar:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
numri i NIPT-it
2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
numri i NIPT-it
Etj.

* * *

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në fazën tjetër të procedurës së sipërcituar këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
numri i NUIS-it
Vlera _____
(me numra dhe fjalë)
2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
numri i NUIS-it
Vlera _____
(me numra dhe fjalë)
Etj.

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhtëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
numri i NUIS-it
2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
numri i NUIS-it
Etj.

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [*emri, Nipti dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues*] se oferta e paraqitur nga ana juaj dhe e vlerësuar me _____ pikë, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit përgjegjës dhe referenca e kontaktit*] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit përgjegjës]

Shtojca 21

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Përgjegjës në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____

2. _____

3. _____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]*

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: ☐ oferta ekonomikisht më e favorshme ☐ çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Vlera _____	
	<i>(me numra dhe fjalë)</i>

2. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm për lidhjen e marrëveshjes kuadër:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____ / Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____ / Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit përgjegjës dhe referenca e kontaktit], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit përgjegjës]

Shtojca 22

KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS

Punët

Neni 1: Qëllimi

- 1.5 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Punëve të prokuruar ne bazë të legjislacionit të prokurimit.
- 1.6 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërise parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.7 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.8 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e parashikuara në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.9 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.9 “Preventiv total” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese, plotesuar me cmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes në një kontratë me çelsa ne dore.
- 2.10 “Preventiv per njesi” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njesi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje.
- 2.11 “Afati i realizimit te punimeve” do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikon për realizimin Punimeve , e vertetuar nga enti prokurues.
- 2.12 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Përgjegjës dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.13 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.14 “Realizimi i punimeve” do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Përgjegjës se Punët janë mbaruar.
- 2.15 “Defekt” do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.
- 2.16 “Data e hyrjes” do të thotë data që Autoriteti Përgjegjës lejon kontraktorin në kantier.
- 2.17 “Data e fillimit” eshte perfshire ne Të dhënat e kontrates. Ajo eshte data kur kontraktori do të filloje punimet e ndertimit. Në se kjo nuk realizohet, “data e fillimit “do te jete dita në të cilën do të paguhet paradhenia.
- 2.18 “Pajisje” do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndertimeve.
- 2.19 “Materiale” do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.
- 2.20 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.21 “Palë(t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.

- 2.22 “Drejtues projekti” do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kon Përgjegjës traktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për autoritetin përgjigjës.
- 2.23 “Autoritet Përgjegjës” do të thotë Autoriteti Përgjegjës që është pjesë e kësaj kontrate dhe që kontraktin punët objekt i kësaj kontrate. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.24 “Kantier” do të thotë vendi fizik i Punimeve.
- 2.25 “Raport i inspektimit të kantierit” do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojnë informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.
- 2.26 “Nënkontraktues” do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.
- 2.27 “Kontraktor” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.
- 2.28 “Standarte Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.
- 2.29 “Ngritja e kantierit” do të thotë punimet e ndertimit të perkohshme, të ndërtuara e instaluar, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndërtimit.
- 2.30 “Punime” do të thotë ajo që Autoriteti Përgjegjës i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të perkufizuara në dokumentat e tenderit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.3 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.
- 3.4 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke sanksionuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikat e Korruptuara, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.4 Autoriteti Përgjegjës mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se kontraktori ka kryer veprime të korruptuara. Veprimet e korruptuara përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 18 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.5 Kontraktori nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ent që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.6 Kontraktori duhet të lejojë autoritetin përgjigjës të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Përgjegjës.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

- 5.3 Kontraktori dhe Autoriteti Përgjegjës duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.4 Kontraktori mund t’i japë nënkontraktorit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Përgjegjës deri në masën e kërkuar që nënkontraktorin të zbatojë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, kontraktori duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktorin një dispozitë që premtun ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6: Prona Intelektuale

- 6.5 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruar nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do t’i përkasin Autoritetit Kontraktor i cili mund t’i përdorë ato sipas gjykimit të tij.

- 6.6 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoritetit Përgjegjës të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikën, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Përgjegjës.
- 6.7 Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Përgjegjës zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.
- 6.8 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Përgjegjës në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t'i japë Autoritetit Përgjegjës të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Materialeve

- 7.7 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.8 Kontraktori mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.
- 7.9 Për qëllime verifikimi "origjinë" do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, bashkuar ose prodhuar. materialet janë prodhuar kur, nëpërmjet prodhimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.10 Origjina e materialeve ka dallim nga kombësia e kontraktorit ose nënkontraktorit që furnizon me materiale.

Neni 8: Vendimet e Drejtuesit të Projektit

- 8.4 Drejtuesi i projektit do të vendosë për çështjet e kontratës midis kontraktorit dhe Autoritetit Përgjegjës.
- 8.5 Drejtuesi i Projektit mund të delegojë ndonjë nga detyrat dhe përgjegjësitë e tij tek të tjerët përveç zgjidhjen e mosmarrveshjeve dhe konflikteve. Drejtuesi i projektit duhet të njoftojë kontraktorin për delegimet e bëra apo të revokuara.

Neni 9: Komunikimi

- 9.3 Çdo komunikim midis palëve duhet të bëhet me shkrim.

Neni 10: Bashkëpunimi në Kantier me të Tjerët

- 10.2 Kontraktori duhet të bashkëpunojë dhe të ndajë kantierin me firma të tjera, autoritete publike, shërbimet publike dhe Autoritetin përgjegjës siç kërkohet dhe përkufizohet në Grafikon e realizimit të punimeve.

Neni 11: Përgjegjësia e Autoritetit Përgjegjës

- 11.5 Autoriteti Përgjegjës ka përgjegjësi të kompensojë kontraktorin për dëmtime të pajisjeve të kontraktorit deri në masën që lidhet me veprime me faj të Autoritetit Përgjegjës ose të projekteve të Autoritetit Përgjegjës me përjashtim të rastit kur keto të fundit, kishin gabime të dukshme që mund të ishin konstatuar lehtësisht nga kontraktuesi.

Neni 12: Raporti i Inspektimit të Kantierit dhe Kushtet e Kantierit

- 12.1 Autoriteti Përgjegjës nuk mban asnjë përgjegjësi për konkluzionet ose interpretimet e bëra në raportin e inspektimit të kantierit.

